



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 54, datë 28.03.2022

**PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT TË KËSHILLTARIT TË ETIKËS, PRANË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËRMES PROCEDURËS SË  
KOMANDIMIT**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 166 pika 2, 184, 182 pika 2 dhe 3, 189 pika 1, germa “b”, të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 47 pika 5, 53 pika 2, si dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Këshilltarit për Etikën, përmes procedurës së komandimit.
2. Afati i komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet.
3. Shprehja e interesit duhet të paraqitet jo më vonë se 2 javë nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.**
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më datë 28.03.2022.

**KRYETARI**

**ALFRED BALLA**

